

Përmbledhje

Sistemi financiar në vend vazhdoi të konsolidohet dhe të zgjerohet edhe më tej. Analiza krahasimore tremujore tregon për rritje të aseteve të sistemit financiar, kryesisht si rezultat i rritjes së aseteve të sektorit bankar dhe atij pensional.

Sektori bankar vazhdoi të karakterizohet me rritje të aktivitetit kreditues, performancë të kënaqshme financiare si dhe nivel të adekuat të indikatorëve kyç që matin shëndetin e sektorit. Në TM3 2018, asetet e sektorit bankar u rritën për 141.8 milionë euro, kryesisht si rezultat i rritjes së bilancit me bankat tjera, bilancit në BQK dhe aktivitetit kreditues. Rritja e gjithsej stokut të kredive, ndër tjera, i atribuohet rritjes së kredive të reja gjatë kësaj periudhe, veçanërisht kredive me karakter investues (ndërmarrje). Sektorët ekonomik që u kredituan më shumë në këtë periudhë bazuar në stokun e kredive ishin ndërtimtaria, bujqësia, prodhimtaria dhe tregtia.

Rritja e kreditimit vazhdon të financohet kryesisht nga depozitat e mbledhura brenda ekonomisë së vendit, të cilat në fund të TM3 2018 përfaqësuan 79.6 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit. Në TM3 2018, depozitat u rritën për 124.1 milionë euro, kryesisht si rezultat i zgjerimit të depozitave të ekonomive familjare të mbajtura në sektorin bankar gjatë kësaj periudhe.

Në TM3 2018, normat e interesit në kredi ndërprejnë trendin rënës, kurse ato në depozita kanë shënuar një rritje të lehtë vjetore. Norma e interesit në kredi në TM3 2018 qëndroi në nivel prej 6.7 përqind, kurse në depozita në 1.5 përqind.

Sektori bankar u karakterizua me performancë të kënaqshme financiare gjatë TM3 2018, duke realizuar fitim neto prej 20.1 milionë euro, por që është më i ulët krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Rënia e lehtë e profitit të realizuar, ishte kryesisht pasojë e rritjes më të lartë të shpenzimeve në këtë tremujor krahasuar me rritjen e nivelit të hyrave.

Sektori bankar shënoi përmirësim të indikatorëve kyç të shëndetit financiar. Në TM3 2018, ky sektor shënoi rënie të nivelit të kredive joperformuese (në 2.8 përqind) dhe përmirësim të mëtejshëm të mbulueshmërisë së tyre me provizione (156.5 përqind). Për më tepër, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (16.1 përqind) dhe nivel i likuiditetit (36.3 përqind) japin indikacione për një sektor mirë të kapitalizuar dhe të mbrojtur nga rreziqet potenciale që mund të shfaqen.

Në TM3 2018, sektori pensional shënoi rritje të aseteve, e cila u reflektua edhe në rritjen e peshës së sektorit në asetet e sistemit financiar krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Në tremujorin e tretë, ky sektor u karakterizua me ecuri pozitive të kontributeve të reja, e po ashtu performancë pozitive sa i përket kthimit bruto nga investimet dhe rritjes së vazhdueshme të çmimit të njësisë.

Sektori i sigurimeve mbylli këtë tremujor me rezultat më të lartë pozitiv financiar krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Më saktësisht, faktorët që ndikuan në dinamikat e sektorit të sigurimeve ishin rritja në të hyrat neto nga primet dhe zvogëlimi i shpenzimeve të sektorit, ndërsa faktorët të cilët kontribuan negativisht ishte rritja e theksuar e dëmeve të ndodhura gjatë TM3 2018.

Sektori mikrofinanciar ka vazhduar të rrisë aktivitetin, ku edhe në tremujorin e tretë u karakterizua me rritje të theksuar të aseteve si rezultat i rritjes së stokut të kredive. Njëkohësisht, dinamikat në këtë sektor dhe rritja e të hyrave rezultuan në rritje të profitit gjatë këtij tremujori.

Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës gjatë këtij tremujori u karakterizua me rritje të vlerës së emetuar dhe rritje të afatit të maturimit, si dhe kërkesë më të lartë për të investuar në letrat me vlerë. Rritja e normës së përgjithshme të interesit në TM3 2018 mund t'i atribuohet deri në një masë orientimi nga emetimi i letrave me vlerë me maturitet më të gjatë.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE-----i

Sistemi Financiar -----	04
Sektori Bankar -----	04
Sektori Pensional-----	12
Sektori i Sigurimeve -----	14
Sektori Mikrofinanciar -----	16
Tregu i Letrave me Vlerë -----	19

GRAFIKËT DHE TABELAT

Figura 1. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës -----	04
Figura 2. Asetet e sektorëve përbërës të sistemit financiar -----	04
Figura 3. Ndryshimi vjetor në strukturën e asetëve të sektorit bankar -----	05
Figura 4. Ndryshimi vjetor në vlerën e gjithsej kredive dhe kategorive kryesore -----	05
Figura 5. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike -----	06
Figura 6. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake -----	07
Figura 7. Vlera e gjithsej depozitave dhe kategorive kryesore në TM2 -----	07
Figura 8. Struktura e bilancit të depozitave në TM3 -----	07
Figura 9. Norma e interesit në kredi dhe depozita -----	08
Figura 10. Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare -----	08
Figura 11. Norma e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik -----	09
Figura 12. Norma e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare -----	09
Figura 13. Norma e interesit në depozitat -----	10
Figura 14. Norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve -----	10
Figura 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare -----	10
Figura 16. Profiti neto i sektorit bankar -----	10
Figura 17. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar -----	11
Figura 18. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	11
Figura 19. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve -----	12
Figura 20. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës -----	12
Figura 21. Asetet e sektorit pensional -----	13
Figura 22. Struktura e asetëve të FKPK-së -----	13
Figura 23. Struktura e asetëve të FSKP-së -----	13
Figura 24. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së -----	14

Figura 25. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	14
Figura 26. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	15
Figura 27. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	16
Figura 28. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve -----	16
Figura 29. Vlera e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik-----	17
Figura 30. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar -----	17
Figura 31. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar-----	17
Figura 32. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik-----	18
Figura 33. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	18
Figura 34. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar-----	19
Figura 35. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	19
Figura 36. Shuma e borxhit të emetuar -----	19
Figura 37. Shuma e ofruar dhe e emetuar -----	20
Figura 38. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë -----	20
Tabela 1. Numri dhe shuma e letrave me vlerë të arkëtuara nga Qeveria e Kosovës-----	20
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	22


SHKURTESAT:

APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CHF	Franku Zvicërran
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik
IHD	Investimet Huaja Direkte
KJP	Kreditë Jopërfomuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
USD	Dollari Amerikan
WEO	World Economic Outlook

Sistemi Financiar

Sistemi financiar vazhdon trendin pozitiv të rritjes, por me ritëm më të ngadalësuar. Sektori bankar ai pensional mbesin si sektorët me kontributin më të lartë në zgjerimin e përgjithshëm të sistemit financiar. Po ashtu, edhe sektorët që kanë peshë më të ulët në gjithsej asetet, mikrofinancat dhe sigurimet, kontribuuan pozitivisht në zgjerimin e sistemit financiar.

Figura 1. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK (2018)


Të gjithë sektorët përbërës të sistemit financiar shënuan rritje në periudhën raportuese duke arritur vlerë prej 6.23 miliardë euro në fund të TM3 2018, që paraqet një rritje vjetore prej 8.0 përqind (figura 1).

Kurse, në baza tremujore, asetet e sistemit financiar u zgjeruan për 223.6 milionë euro në TM3 2018, kryesisht si rezultat i zgjerimit të sektorit pensional, përderisa sektorët tjerë vazhduan trendin e njëjtë me periudhën paraprake (figura 2).

Zgjerimi i aktivitetit të sektorit bankar dhe atij mikrofinanciar vazhdon të mbështetet prej depozitave të klientëve, përkatësisht huazimeve nga

sektori i jashtëm (linjave të ndryshme kreditore). Ndërsa, zgjerimi i asetëve të sektorit pensional u mbështet nga arkëtimet e reja dhe kthimi pozitiv nga investimet e asetëve në tregjet e huaja. Sektori i sigurimeve, u karakterizua me rritje të primeve bruto të shkruara si dhe përmirësim të performancës financiare.

Figura 2. Asetet e sektorëve përbërës të sistemit financiar



Sektori Bankar


Sektori bankar gjatë këtij tremujori u karakterizua me rritje më të lartë të aktivitetit kreditues, rënie të investimeve në letrat me vlerë, përderisa indikatorët kyç të shëndetit financiar vazhdojnë të jenë në nivel optimal.

Asetet

Në TM3 2018, asetet e sektorit bankar u zgjeruan për 141.8 milionë euro dhe arritën vlerën prej 4.03 miliardë euro në fund të periudhës. Rritja e përgjithshme e asetëve të sektorit bankar vazhdon të jetë rezultat i ecurisë pozitive të kreditimit, që në masë të madhe u ndikua nga oferta e lehtësuar për

kredi e aplikuar nga bankat. Kurse në baza tremujore, gjatë TM3 2018 pothuajse të gjitha kategoritë e asetëve shënuan rritje, përjashtuar investimet në letrat me vlerë (figura 3).

Figura 3. Ndryshimi vjetor në strukturën e asetëve të sektorit bankar



Bilanci me bankat tjera ishte kategoria e cila shënoi rritjen më të lartë në këtë tremujor për 75.9 milionë euro (43.9 milionë euro në TM3 2017), dhe arriti vlerën prej 330.1 milionë euro në fund të periudhës së cekur. Për dallim nga tremujori i njëjtë i vitit paraprak, paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në shënoi rritje më të ngadalësuar në TM3 2018, duke u zgjeruar për 56.8 milionë euro (për 70.3 milionë në TM3 2017) dhe arriti vlerën prej 483.8 milionë euro në fund të periudhës së cekur. Ngadalësimi i rritjes së kësaj kategorie kryesisht reflekton nivelin e parasë së gatshme të mbajtur në trezor të bankave dhe në BQK, që në TM3 2018 u rrit për 51.5 milionë euro, kundrejt rritjes për 72.0 milionë euro në TM3 2017.


Në TM3 2018, stoku i letrave me vlerë të sektorit bankar u zvogëluar për 16.6 milionë euro dhe zbriti në vlerë prej 434.2 milionë euro në fund të periudhës raportuese. Investimi në letrat me vlerë të qeverisë së Kosovës vazhdon të shënojë rritje, mirëpo investimet

në letrat me vlerë të qeverive të huaja shënuan rënie, dinamikë që u reflektua në rënieën e investimeve në këtë instrument gjatë TM3 2018. Poashtu, normat e ulëta të kthimit në letra me vlerë mund të kenë ndikuar në orientimin e bankave drejt investimeve në kreditim, si instrument me kthim më të lartë.

Kreditë

Aktiviteti kreditues vazhdon të karakterizohet me rritje të përsheptuar edhe gjatë TM3 2018. Në fund të periudhës së cekur, kreditë arritën vlerën prej 2.68 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 11.4 përqind. Në baza tremujore, kreditë u rritën për 19.8 milionë euro, krahasuar me rritjen për 16.6 milionë euro në TM3 2017 (figura 4).

Figura 4. Ndryshimi vjetor në vlerën e gjithsej kredive dhe kategorive kryesore




Ndikim pozitiv në rritjen e kredive aktive gjatë TM3 2018 kishin kreditë e reja të lëshuara si për ndërmarrjet (të cilat shënuan vlerën prej 181.6 milionë euro) ashtu edhe për ekonomitë familjare (që shënuan vlerën prej 113.3 milionë euro). Ofertat më të favorshme bankare, shprehur përmes përmirësimit të kushteve të kreditimit si për ndërmarrjet edhe ekonomitë familjare rezultuan në rritjen e gjithë

stokut të kredive aktive deri në fund të periudhës së cekur.

Në TM3 2018, kreditë për ndërmarrje shënuan rritje për 6.1 milionë euro (rënie për 3.9 milionë euro në TM3 2017), duke arritur vlerën prej 1.70 miliardë euro në fund të periudhës së cekur. Në baza vjetore, në fund të TM3 2018, përjashtuar sektorin e shërbimeve tjera, kreditimi ndaj të gjithë sektorët tjerë ekonomik u karakterizua me rritje dyshifrore. Sektori i ndërtimitarisë kishte rriten më të lartë vjetore, pasuar nga ai i bujqësisë, prodhimtarisë dhe tregtisë.

Figura 5. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike



Kurse, në baza tremujore, për shkak të efektit të sezonalitetit, kemi ndryshime të theksuara sa i përket rritjes së kredive në TM3 në sektor specifik të ekonomisë (figura 5). Sektorët e vetëm që shënuan rritje të kreditimit në këtë tremujor ishin ai i ndërtimitarisë (për 8.9 milionë euro), prodhimtarisë (për 7.9 milionë euro), dhe shërbimeve financiare (për 0.4 milionë euro). Kurse, me rënie të kreditimit në këtë tremujor u karakterizua sektori i tregtisë (për 8.4 milionë euro) dhe ai i bujqësisë (për 2.1 milionë euro). Kreditë e reja për ndërmarrje gjatë TM3 2018 arritën vlerën në 181.6 milionë euro, prej të cilave


111.8 milionë euro të destinuar për investime, kurse 65.8 milionë euro për qëllime jo-investuese. Kreditë e reja për sektorin e bujqësisë u rritën për 0.8 milionë euro krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, në 5.0 milionë euro në TM3 2018. Kreditë e reja të destinuar për industrinë u zvogëluan për 1.6 milionë euro, duke arritur vlerën në 51.3 milionë euro në TM3 2018. Kurse, kreditë e reja për sektorin e shërbimeve u rritën për 2.8 milionë euro, duke arritur vlerën në 106.8 milionë euro në TM3 2018.

Kreditë ndaj ekonomive familjare në TM3 2018 u rritën për 14.8 milionë euro, duke arritur vlerën e stokut të gjithsej kredive prej 973.2 milionë euro. Kjo rritje ndër tjerash reflekton ecurinë në kreditë e reja të lëshuara nga bankat gjatë kësaj periudhe. Më konkretisht, gjatë këtij tremujori, vlera e kredive të reja të destinuar për konsum arriti vlerën në 79.1 milionë euro, apo 5.8 milionë euro më e ulët krahasuar me ecurinë në TM3 2017. Kurse, kreditë e reja hipotekare të lëshuara nga bankat arritën vlerën prej 24.5 milionë euro, apo 5.2 milionë euro më shumë se sa vlera në TM3 2017.

Detyrimet dhe Burimet Vetanake

Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake të sektorit bankar dominohet nga depozitat, të cilat përbëjnë 79.6 përqind të gjithsej detyrimeve. Në këtë tremujor depozitat u rritën për 124.1 milionë euro, që është dukshëm më e ulët se sa rritja prej 159.1 milionë euro në TM3 2017 (figura 6).

Figura 6. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake




Burimi: BQK (2018)

Kategoria e dytë më e rëndësishme, ajo e burimeve vetanake, u karakterizua me rënie për 16.0 milionë euro në TM3 2018 (0.5 milionë euro rënie gjatë TM3 2017). Kjo rënie i atribuohet kryesisht shpërndarjes së dividendës në këtë tremujor e që ishte më e lartë se sa profiti i realizuar gjatë këtij tremujori. Kategoria e cila shënoi rritje të theksuar gjatë këtij tremujori ishte bilanci nga bankat tjera, që u rritë për 30.7 milionë euro kundrejt rënies për 20.9 milionë në TM3 2017, e që kryesisht është rezultat i marrjes hua apo linjave të ndryshme kreditore nga bankat jashtë vendit, përkatësisht bankat amë.

Depozitat

Depozitat në sektorin bankar të Kosovës u rritën për 124.1 milionë euro në TM3 2018 në baza tremujore, dhe shënuan vlerën prej 3.21 miliardë euro. Dinamikat që karakterizuan depozitat e sektorit bankar në TM3 2018 i atribuohen zhvillimeve si në kuadër të depozitave për ndërmarrjet ashtu edhe për ekonomitë familjare. Depozitat e ndërmarrjeve u rritën për 69.0 milionë euro në këtë tremujor dhe arritën vlerën prej 767.7 milionë euro në fund të periudhës së cekur.


Figura 7. Vlera e gjithsej depozitave dhe kategorive kryesore në TM3



Burimi: BQK (2018)

Në anën tjetër, depozitat për ekonomitë familjare u rritën për 49.3 milionë euro në këtë tremujor, dhe arritën vlerën prej 2.28 miliardë euro në fund të periudhës së cekur (figura 7).

Figura 8. Struktura e bilancit të depozitave në TM3



Burimi: BQK (2018)

Rritja e depozitave të ekonomive familjare në këtë tremujor mund t'i atribuohet deri në një masë rritjes së të hyrave në ekonomi (rritjes së pagës neto mesatare¹) dhe rritjes së remitencave përgjatë vitit 2018. Gjithashtu, rritja e lehtë e normave të interesit në depozita mund të ketë pasur efekt pozitiv në

¹ Sipas Buletinit Tremujor TM2 2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) (Korrik 2018)


rritjen e gjithsej depozitave të ekonomive familjare në sektorin bankar.

Sipas kategorive të depozitave, depozitat e transferueshme u rritën për 91.5 milionë euro në TM3 2018 (figura 8), dhe shënuan vlerën prej 1.93 miliardë euro në fund të periudhës së cekur. Gjithashtu, depozitat e afatizuara u rritën për 47.1 milionë euro në këtë tremujor dhe arritën vlerën prej 821.0 milionë euro në fund të periudhës. Në anën tjetër, depozitat e kursimit u zvogëluan për 5.9 milionë euro në baza tremujore, dhe zbritën në vlerë prej 465.7 milionë euro në fund të periudhës së cekur.

Normat e Interesit²

Në TM3 2018, normat e interesit në kredi kanë ndërprerë trendin e theksuar të rënies, kurse ato në depozita kanë shënuar një rritje të lehtë vjetore. Dallimi në mes të normës të interesit në kredi dhe asaj në depozita u zvogëlua në 5.2 pikë përqindje (5.5 pikë përqindje në TM3 2017).

Figura 9. Norma e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK (2018)


Norma e interesit në kredi në TM3 2018 u rrit për 0.1 pikë përqindje, në 6.7 përqind përdërisa norma e interesit në depozita shënoi rritje për 0.4 pikë përqindje, në 1.5 përqind (figura 9).

Normat e interesit në kredi

Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve u rrit në 6.2 përqind, nga 6.0 përqind sa ishte në TM3 2017 (figura 10).

Pothuajse të gjitha kategoritë e normave të interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në TM3 2018 shënuan rritje vjetore. Rritja më e madhe (0.2 pikë përqindje) u shënuar tek kreditë për qëllime investuese, kredi që kishin një normë interesi prej 6.2 përqind. Në periudhën raportuese, normat e interesit në kreditë për qëllime jo-investuese bartën normë të interesit prej 6.3 përqind, që paraqet një rritje vjetore prej 0.1 pikë përqindje. Në anën tjetër, normat e interesit të aplikuara për kreditë me kushte favorizuese shënuan rënie gjatë kësaj periudhe në 3.1 përqind, një rënie vjetore prej 1.4 pikë përqindje.

Figura 10. Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare




Burimi: BQK (2018)

² Kalkulimi i normave të interesit: mesatarja tremujore e normave të interesit në kredi, gjegjësisht në depozita. Në tekst ju referohemi si 'normë e interesit'.

ormat e interesit në kreditë ndaj sektorëve ekonomik në përgjithësi gjatë këtij tremujori shënuan rritje të lehtë vjetore krahasuar me tremujorin e tretë të vitit paraprak, përjashtuar sektorin e industrisë, që u karakterizua me rënie vjetor prej 0.1 pikë përqindje, në 6.0 përqind (figura 11). Normat e interesit për sektorin e bujqësisë shënuan rritje më të lartë, për 1.6 pikë përqindje krahasuar me TM3 2017, duke arritur në 8.4 përqind në TM3 2018.

Figura 11. Norma e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2018)

Normat e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare ndoqën trendin e përgjithshëm të normave të interesit të aplikuara nga bankat. Normat e interesit të aplikuara për kreditë hipotekare vazhdojnë të jenë më të favorshme, duke qenë se kreditë e destinuar për këtë kategori të ekonomive familjare janë të siguruara me patundshmëri.

Në TM3 2018, norma e interesit e aplikuar për kreditë hipotekare qëndroi në 6.1 përqind, një rritje prej 0.2 pikë përqindje krahasuar me TM3 2017. Përderisa, normat e interesit të aplikuara për kreditë konsumuese janë dukshëm më të larta dhe qëndrojnë mesatarisht në 7.7 përqind, ngjashëm me periudhën paraprake.

Figura 12. Norma e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare, sipas qëllimit



Burimi: BQK (2018)

Normat e interesit në depozita


Normat e interesit në depozita, pavarësisht rritjes së lehtë në vitin e fundit, vazhdojnë të jenë në nivele mjaftë të ulëta krahasuar me periudhat para vitit 2014 (figura 13).

Normat e interesit në depozitat për ndërmarrjet vazhdojnë të jenë më të favorshme krahasuar me normat që ofrohen për ekonomitë familjare.

Në depozitat e ndërmarrjeve, norma e interesit qëndroi në nivel prej 1.8 përqind në TM3 2018, një rritje për 0.3 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e tretë të vitit paraprak. Më konkretisht, rritje shënuan normat e interesit në depozitat e afatizuara (1.8 përqind në TM3 2018 nga 1.5 përqind në TM3 2017). Normat e interesit në depozitat e kursimit të ndërmarrjeve shënuan ngritje të lehtë kurse ato të transferueshme mbetën në nivele të ngjashme me

periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (figura 14).


Figura 13. Norma e interesit në depozita



Burimi: BQK (2018)


Normat e interesit në depozitat e ekonomive familjare qëndruan në 1.4 përqind në TM3 2018 (figura 15). Norma e interesit në depozitat e transferueshme (0.001 përqind), të kursimit (0.3 përqind) dhe ato të afatizuara (1.4 përqind) në TM3 2018 janë të përafërta me normat e aplikuara në TM3 2017, dhe pothuajse të pandryshueshme nga tre vitet e fundit, përjashtuar normat e aplikuara në depozitat e afatizuara në këtë tremujor që shënuan rritje.

Figura 14. Norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve, sipas kategorive



Burimi: BQK (2018)

Figura 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive




Burimi: BQK (2018)

Performanca e sektorit bankar

Vlera e profitit të realizuar në TM3 2018 arriti në 20.1 milionë euro, për 3.4 milionë euro më e ulët krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (figura 16).

Figura 16. Profiti neto i sektorit bankar, në milionë euro




Burimi: BQK (2018)

Rënia e lehtë e profitit të realizuar në TM3 2018 i atribuohet rritjes më të lartë të shpenzimeve të ndodhura krahas rritjes së të hyrave.

Të hyrat e sektorit bankar në TM3 2018 u karakterizuan me rritje të lehtë, kryesisht si rezultat

i rritjes së të hyrave nga jo-interesi, përkatësisht të hyrave nga tarifat dhe komisionet, dhe të hyrave nga rivlerësimi. Ndërsa, të hyrat nga interesi shënuan rënie të lehtë krahasuar me vlerën e arkëtimit në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. (figura 17).


Figura 17. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar



Burimi: BQK (2018)

Në anën tjetër, vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar në TM3 2018 arriti në 42.6 milionë euro, një rritje prej 4.2 milionë euro kundrejt tremujorit të njëjtë të vitit paraprak (figura 17).

Figura 18. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Shënim: Në kalkulim të KMA dhe KMK profiti për tremujorin përkatës është anualizuar
Burimi: BQK (2018)

Rritja e shpenzimeve të sektorit bankar kryesisht i atribuohet rritjes së shpenzimeve të jo-interesit që u

rrit për 11.6 milionë euro më shumë në këtë tremujor krahasuar me TM3 2017. Në kuadër të shpenzimeve të jo-interesit, ndikimin më të lartë në rritje e kishin nënkategoria e provizioneve të ndara për humbjet e mundshme në kredi, pasuar nga ato për tarifat dhe komisionet. Në kuadër të shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, në krahasim me TM3 2017, nënkategoria e shpenzimeve të personelit dhe shpenzimeve të përgjithshme shënuan rënie. Po ashtu, shpenzimet e interesit gjatë këtij tremujori shënuan rënie të lehtë krahasuar me TM3 2017, si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve për interesa në depozita.

Si rrjedhojë e zhvillimeve në të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar, raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave në TM3 2018 u rrit për 5.9 pikë përqindje kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, duke qëndruar në 67.9 përqind (figura 17).

Performanca financiare e sektorit bankar në këtë tremujor u reflektua edhe në dy indikatorët e profitabilitetit, kthimin në mesataren e aseteve (KMA) edhe kthimin në mesataren e kapitalit (KMK). Në TM3 2018, KMA u zvogëlua për 0.8 pikë përqindje në 2.3 përqind, përderisa KMK u zvogëlua për 5.6 pikë përqindje në 19.3 përqind (figura 18). Rënia e indikatorëve në fjalë pasqyron fitimin më të ulët të këtij tremujori kundrejt tremujorit të njëjtë të vitit paraprak.


Treguesit e shëndetit financiar

Sektori bankar edhe gjatë tremujorit të tretë të vitit 2018 u karakterizua me rënie të nivelit të kredive joperformuese dhe përmirësim të mbulueshmërisë së

tyre me provizione. Niveli i kredive joperformuese në fund të TM3 2018 qëndroi në 2.8 përqind, që paraqet një rënie prej 0.8 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 19).

Niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione u përmirësua edhe më tej, duke qëndruar në 156.5 përqind, një rritje që kryesisht i atribuohet rënies së vlerës së kredive joperformuese.

Figura 19. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve




Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK (2018)

Niveli i kapitalizimit të sektorit bankar vazhdon të jetë dukshëm mbi nivelin minimal të kërkuar me rregullore prej 12.0 përqind. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në fund të TM3 2018 qëndroi në nivel prej 16.1 përqind.

Treguesi kyç i likuiditetit, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra, shënoi rënie në fund të TM3 2018 për 2.4 pikë përqindje kundrejt TM3 2017. Ky indikator qëndroi në nivel prej 36.3 përqind në periudhën raportuese. Rënia e këtij treguesi i atribuohet rritjes së kredive (gjë që rezultoi në zvogëlim të aseteve likuide) dhe rritjes së detyrimeve afatshkurtra (si rezultat i rritjes së depozitave të transferueshme) (figura 20). Për më tepër, raporti kredi/depozitë në fund të TM3 2017

qëndroi në nivel prej 83.5 përqind, dhe kaloi lehtësisht nivelin e rekomanduar nga Banka Qendrore e Kosovës prej 80.0 përqind, si rezultat i rritjes më të lartë të aktiviteti kreditues krahasuar me rritjen e depozitave në sektorin bankar.

Figura 20. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës




Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK (2018)

Sektori pensional

Sektori pensional gjatë TM3 2018 u karakterizua me rritje, si rezultat i kontributeve të reja të arkëtuara dhe performancës pozitive të mjeteve të investuara, kryesisht në tregjet e jashtme.

Sektori pensional vazhdon të jetë sektori i dytë për nga pjesëmarrja në asetet e sistemit financiar me 28.3 përqind të gjithsej aseteve. Stoku i aseteve të këtij sektori deri në shtator 2018 arriti vlerën prej 1.76 miliardë euro, një rritje vjetore prej 11.2 përqind.

Figura 21. Asetet e sektorit pensional, ndryshimi tremujor




Burimi: BQK (2018)

Gjatë TM3 2018, asetet e menaxhuara nga sektori pensional u shtuan për 69.6 milionë euro, dukshëm vlerë më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (figura 21). Kjo rritje e asetëve reflekton ecurinë e performancës së investimeve, kryesisht të alokuara jashtë vendit, dhe përbëjnë pjesën më të madhe të asetëve të fondeve. Më konkretisht, stokut të investimeve në fondet e përbashkëta të FKPK-se, që zotëron 99.6 përqind të gjithsej asetëve të sektorit pensional, në këtë tremujor iu shtuan 34.0 milionë euro. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe edhe investimet në vend, përkatësisht në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës u shtuan për 40.9 milionë euro.

Fondet pensionale që operojnë në Kosovë kanë strategji të ndryshme të investimit të asetëve të tyre. FKPK vazhdon të ndjekë një strategji të kujdesshme të investimit, duke siguruar diversifikim të rrezikut nga investimi në fonde të përbashkëta investuese të cilat menaxhohen nga ndërmarrjet për menaxhimin e mjeteve.


Figura 22. Struktura e asetëve të FKPK-së (TM3 2018)



Burimi: FKPK (2018)

Në anën tjetër, FSKP investon asetet e tyre kryesisht në aksione jashtë vendit, pasuar nga asetet e investuara në obligacione si në Kosovë ashtu edhe jashtë vendit (figura 22 dhe 23).


Figura 23. Struktura e asetëve të FSKP-së (TM3 2018)



Burimi: FSKP (2018)

Arkëtimet të reja gjatë tremujorit të tretë të vitit 2018 u regjistruan në vlerë prej 43.4 milionë euro, që paraqet një rritje prej 6.8 përqind në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Nga këto kontribute të arkëtuara, 99.7 përqind i takojnë FKPK-së.

Figura 24. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së




Në këtë tremujor FKPK kishte performancë pozitive nga investimet ku vlerësimi i aseteve të investuara u rrit duke rezultuar në një kthim bruto prej 35.6 milionë euro krahas kthimit bruto prej 10.2 milionë në tremujorin e tretë të vitit paraprak (figura 24). Ndërsa, FSKP pati një ngadalësim të kthimit bruto nga investimet duke zbritur në 225.9 mijë euro nga 349.4 mijë euro në TM3 2018.

Sektori i sigurimeve

Rritja e të hyrave nga primet dhe menaxhimi efikas i shpenzimeve operative ndikuan që sektori të kishte rezultat pozitiv financiar. Si rezultat i dinamikave pozitive në sektor, rritja e shpenzimeve për dëmet e paguara nuk ndikoi në nivelin e të hyrave neto, të cilat megjithatë rezultuan të jenë më të larta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Asetet e sektorit të sigurimeve gjatë TM3 2018 u karakterizuan me rritje të përshpejtuar, duke ndihmuar në rikuperimin gradual të sektorit nga gjendja jo e favorshme financiare e sektorit në vitet paraprake.

Figura 25. Asetet e sektorit të sigurimeve, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK (2018)

Në TM3 2018, asetet e sektorit të sigurimeve u zgjeruan për 6.3 milionë euro dhe arritën vlerën prej 181.0 milionë euro në fund të periudhës, krahasuar me rritjen prej 3.3 milionë euro në TM3 2017 (figura 25).


Gjatë këtij tremujori, strategjia e mbajtjes së aseteve u zhvendos nga paratë e gatshme dhe depozitat në banka, të cilat u karakterizuan me rënie, në investimeve në letrat me vlerë, të cilat shënuan rritje. Kjo strategji mund të jetë ndikuar nga rritja e normës së kthimit nga ky instrument gjatë tremujorit raportues.

Ecuria e gjithsej aseteve të sektorit reflekton zhvillimet në sektorin e sigurimeve 'jo-jetë', asetet e të cilave u shtuan për 4.1 milionë gjatë tremujorit të tretë. Edhe pse sektori 'jetë' ka peshë të vogël në gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve, rritja e aseteve të tyre për 2.2 milionë euro ndikoi po ashtu në ecurinë pozitive të aseteve të sektorit.

Vlera e primeve të shkruara nga kompanitë e sigurimeve gjatë TM3 2018 arriti vlerën prej 24.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 4.3 përqind. Primet e sigurimit jo-jetë përfaqësojnë 96.9

përqind të gjithsej strukturës së primeve të shkruara. Vlera e primeve të shkruara nga sigurimi ‘jo-jetë’ u rrit për 3.9 përqind dhe arriti në 24.1 milionë euro. Ndërsa, vlera e primeve të shkruara nga sigurimi ‘jetë’ u karakterizua me rritje vjetore prej 18.0 përqind duke arritur në 673.7 mijë euro.

Figura 26. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) u rritën në 11.5 milionë euro në TM3 2018 (9.8 milionë euro në TM3 2017), që paraqet një rritje vjetore prej 17.4 përqind. Pavarësisht rritjes në arkëtimet prej primeve të shkruara, niveli më i lartë i dëmeve të paguara ndikoi në përkeqësimin e raportit dëme/prime, i cili në TM3 2018 arriti në 46.4 përqind nga 41.2 përqind sa ishte në tremujorin e tretë të vitit 2017. Ky zhvillim nënkupton që një shumë më e lartë e të ardhurave nga primet duhet të dedikohet për mbulimin e dëmeve (figura 26).

Performanca e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve në TM3 2018 shënoi performancë më të mirë financiare krahasuar me TM3 2017, si

pasojë e rënies së shpenzimeve dhe rritjes së të hyrave.

Të hyrat neto nga primet e sektorit të sigurimeve në TM3 2018 shënuan rritje vjetore prej 6.8 përqind, përderisa në të njëjtën periudhë, shpenzimet e sektorit të sigurimeve u karakterizuan me rënie prej 11.3 përqind krahasuar me TM3 2017. Rrjedhimisht, rritja e të hyrave dhe rënia e shpenzimeve zbutën ndikimin e rritjes së dëmeve të ndodhura prej 38.2 përqind, duke rezultuar në një fitim më të lartë krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak prej 1.3 milionë euro (1.1 milionë euro në TM3 2017).

Sa i përket pozitës së likuiditetit të sektorit, ky indikator shënoi përmirësim të lehtë në TM3 2018, duke marr për bazë stokun e aseteve deri në shtator 2018. Përmirësimi i indikatorit të likuiditetit të sektorit i atribuohet kryesisht rënies vjetore më e vogël të stokut të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj (0.7 përqind) kundrejt rënies së rezervave teknike (0.9 përqind), ku raporti në mes tyre arriti në 98.7 përqind nga 98.6 përqind në shtator 2017. Përderisa, treguesi tjetër i likuiditetit u zvogëlua në masë të vogël, kryesisht i ndikuar nga rritja e gjithsej detyrimeve prej 1.3 përqind kundrejt rënies së lehtë të stokut të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve në shtator 2018 qëndroi në 87.0 përqind, nga 88.8 përqind sa ishte në shtator të vitit të kaluar.


Sektori mikrofinanciar

Rritja e konsiderueshme e asetëve të sektorit vazhdon të jetë e ndikuar kryesisht nga rritja e theksuar e kreditimit nga ky sektor. Rrjedhimisht, sektori u karakterizua me rritje të të hyrave dhe performancë pozitive financiare.

Asetet

Sektori mikrofinanciar ishte sektori me rritjen më të lartë të stokut të asetëve në kuadër të sistemit financiar deri në shtator të vitit 2018. Edhe pse pesha e këtij sektori në gjithsej asetet e sistemit financiar është rritur, vazhdon të mbetet e ulët në rreth 3.8 përqind.

Figura 27. Asetet e sektorit mikrofinanciar, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK (2018)


Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2018, vlera e asetëve të sektorit mikrofinanciar ishte 13.1 milionë euro (12.8 milionë euro në TM3 2017) (figura 27), duke arritur në 236.2 milionë euro në shtator 2018.

Zgjerimi i sektorit mikrofinanciar kryesisht i atribuohet rritjes së aktivitetit kreditues, aktivitet që financohet kryesisht nga huazimet në sektorin e jashtëm (68.5 përqind të gjithsej asetëve).

Kreditë

Gjatë TM3 2018, stoku i kredive u shtua për 7.4 milionë euro, një rritje për 1.1 milionë euro kundrejt vlerës në TM3 2017 (figura 28). Kreditë për ekonomitë familjare, që kanë një pjesëmarrje prej 65.6 përqind në gjithsej kreditë e sektorit, përsheptuan rritjen për 5.5 milionë euro (4.4 milionë euro në TM3 2017). Në anën tjetër, kreditë ndaj ndërmarrjeve, që përfaqësojnë 34.4 përqind të gjithsej kredive të sektorit, u shtuan për 1.9 milionë euro e që është vlerë e ngjashme me atë të TM3 2017. Si rezultat i këtyre dinamikave, stoku i kredive të lëshuara për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare shënoi rritje të theksuar vjetore.

Figura 28. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve, ndryshimi vjetor i kredive




Burimi: BQK (2018)

Sa i përket kreditimit ndaj sektorëve ekonomik, stoku i kredive ndaj sektorëve më të rëndësishëm kreditues siç janë ai i bujqësisë, ndërtimtarisë, tregtisë dhe industrisë u karakterizuan me ecuri pozitive gjatë këtij tremujori. Kreditë për sektorin e bujqësisë përveç që kishin rritje marginale gjatë tremujorit, ato ishin edhe më të ulëta krahasuar me ecurinë në TM3 2017. Sektori që shënoi rritjen më të lartë në këtë tremujor ishte ai i tregtisë prej 0.5 milionë euro, që

përfaqëson një nga kategoritë më të rëndësishme të kredive për ndërmarrje (12.9 përqind të gjithsej stokut të kredive) (figura 29).


Figura 29. Vlera e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik në TM3



Lizingjet

Stoku i lizingjeve gjatë tremujorit të tretë të vitit 2018 u shtua për 2.6 milionë euro (0.5 milionë euro në TM3 2017) (figura 30).

Figura 30. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar




Në rritjen e vlerës së lizingjeve gjatë këtij tremujori kontribuoi rritja e “lizingjeve tjera” kryesisht për

ndërmarrje dhe rritja e lizingut hipotekar për ekonomitë familjare.

Normat e Interesit

Normat mesatare të interesit në kredi përgjithësisht ndoqën trendin rritës të dy viteve të fundit, duke arritur në 25.2 përqind, nga 22.4 përqind sa ishte mesatarja për TM3 2017. Përjashtim bëjnë normat e interesit për ndërmarrjet të cilat u karakterizuan me rënie për dallim nga tremujori i njëjtë i vitit paraprak.

Figura 31. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar




Norma e interesit për kreditë ndaj ekonomive familjare u rritën konsiderueshëm për 4.6 pikë përqindje, ndërsa norma e interesit për kreditë ndaj ndërmarrjeve u karakterizua me rënie prej 0.5 pikë përqindje (figura 31). Në kuadër të ekonomive familjare, norma mesatare e interesit në kreditë konsumuese shënoi rritje të konsiderueshme për 31.4 pikë përqindje në 56.0 përqind, ndërsa për kreditë hipotekare ajo u zvogëlua për 3.0 pikë përqindje në 22.4 përqind.

Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i shërbimeve vijon të ketë normën më të ulët të interesit në kredi. Ndërsa, sektori i industrisë mbetet

sektori me normën më të lartë të interesit në kredi, përkundër rënies prej 1.6 pikë përqindje të normës së interesit krahas TM3 2017 (figura 32).

Figura 32. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2018)

Performanca e sektorit mikrofinanciar

Zhvillimet në aktivitetin kreditues dhe aktivitetin e lizingut në kuadër të sektorit rezultuan në performancë të mirë financiare për institucionet mikrofinanciare edhe gjatë TM3 2018. Profiti i sektorit u shtua në vlerë prej 2.7 milionë euro kundrejt TM3 2017 kur ky sektor realizoi profit prej 2.2 milionë euro (figura 33).

Rritja e profitit kryesisht i atribuohet rritjes së theksuar të hyrave prej 2.8 milionë euro, vlera e të cilave arriti në 11.1 milionë euro në TM3 2018. Më konkretisht, rritja e profitit i atribuohet rritjes të hyrave nga interesi për 2.5 milionë euro, kategori që përfaqëson rreth 88.0 përqind të gjithsej të hyrave.


Figura 33. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2018)

Rritja e të hyrave nga interesi ishte rezultat i rritjes së aktivitetit kreditues nga institucionet mikrofinanciare në tre vitet e fundit, e po ashtu rezultat i rritjes së normës së interesit të aplikuar për kredi. Gjithsej shpenzimet e sektorit po ashtu shënuan rritje prej 2.4 milionë euro dhe arritën në 8.5 milionë euro në TM3 2018. Rritjen më të madhe e patën shpenzimet nga jo-interesi, prej 5.0 milionë euro, si rezultat i rritjes së shpenzimeve për personelin dhe atyre administrative. Në ecurinë e shpenzimeve të sektorit kontribuoi edhe rritja e shpenzimeve për provizionet për humbjet e mundshme nga mos kthimi i kredive, edhe pse në masë më të vogël.

Figura 34. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar




*Profiti është analizuar për tremujorin përkatës
 Burimi: BQK (2018)

Si rezultat i performancës pozitive financiare gjatë tremujorit të parë, treguesit e profitabilitetit të kalkuluar për gjithë vitin shënuan përmirësim, përveç treguesit të kthimit nga kapitali i cili në krahasim me TM3 2017 u zvogëlua për shkak të rritjes më të lartë në kapital se në fitim gjatë periudhës TM3 2018 (figura 34).

Institucionet mikrofinanciare vazhdojnë të karakterizohen me nivel të ulët të kredive me probleme dhe mbulueshmëri të mirë me provizione.

Figura 35. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë




Burimi: BQK (2018)

Niveli i kredive joperformuese në raport me gjithësej kreditë deri në shtator 2018 mbeti i pandryshuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, në 2.8 përqind (figura 35). Kurse, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione në shtator 2018 arriti në 186.3 përqind krahasuar me nivelin prej 185.0 përqind në shtator 2017.

Tregu i letrave me vlerë

Gjatë tremujorit të tretë, Departamenti i Thesarit i Ministrisë së Financave të Qeverisë së Kosovës realizoi 6 ankande, në të cilat u emetuan bono dhe fletë-obligacione qeveritare në vlerë prej 107.0 milionë euro (figura 36).

Figura 36. Shuma e borxhit të emetuar, rritja vjetore



Burimi: Ministria e Financave

Vlera e emetuar e letrave me vlerë në këtë tremujor ishte 33.8 përqind më e lartë se në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar, kurse për 6.5 përqind më e ulët se në tremujorin paraprak. Rritjen e theksuar në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, e ndikoi rritja e vlerës së emetuar të fletë-obligacioneve qeveritare dhe zgjatja e afatit të maturimit të tyre në një afat të ri prej 10 vite (tabela 36).


Tabela 1. Numri dhe shuma e letrave me vlerë të arkëtuara nga Qeveria e Kosovës

Periodha	Bonot e thesarit		Fletë-obligacionet	
	Numri i realizuar	Vlera e pranuar	Numri i realizuar	Vlera e pranuar
TM3 2015	3	53.60	2	35.00
TM3 2016	2	35.00	2	50.00
TM3 2017	1	30.00	3	50.00
TM3 2018	1	20.00	5	87.00

Burimi: Ministria e Financave (2018)

Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë në TM3 2018 ka shënuar rritje (2.58 përqind) krahasuar me TM3 2017 (1.53 përqind). Kjo rritje mund të jetë ndikuar nga emetimi i fletë-obligacioneve me maturitet më të gjatë krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, e sidomos emetimi për herë të parë i fletë-obligacioneve me afat maturimi prej 10 viteve. Po ashtu, rritja e normës mesatare të interesit mund të jetë ndikuar edhe nga interesimi i pjesëmarrësve në ankande të letrave me vlerë. Shuma e ofertuar nga pjesëmarrësit në ankand ishte për 1.3 herë më e lartë se shuma e emetuar në ankande nga Ministria e Financave (1.5 herë më e lartë në TM3 2017) (figura 37).

Figura 37. Shuma e ofruar dhe emetuar




Burimi: Ministria e Financave (2018)

Struktura e letrave me vlerë sipas afatit të maturimit në këtë tremujor dominohet nga fletë-obligacionet qeveritare me afat maturimi 5 vite me pjesëmarrje

prej 42.1 përqind, përdërisa bonot e thesarit me afat maturimi 365 ditë dhe fletë-obligacionet me afat maturimi 2 vite kishin një pjesëmarrje të ngjashme prej 18.7 përqind në gjithsej letrat me vlerë të emetuara gjatë këtij tremujori.

Figura 38. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave (2018)

Ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, nuk janë emetuar bono me afat maturimi nën 365 ditë, kurse trendi i emetimit të letrave me vlerë është i orientuar nga emetimi i fletë-obligacioneve qeveritare me afat më të gjatë të maturimit (figura 38).

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2018): Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar Nr. 24, TM3 2018, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2018):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>

ASK (2018):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>
- f) Buletini Tremujor

Të tjera (2018):

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,46>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://www.fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës; Raporte tremujore: <http://www.trusti.org/sq/per-ne/raporte/835-2/>

Bloomberg (2018): Metal Prices database.

FAOUN (2018): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2018): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2018): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	TM3 2017	TM3 2018
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)	-	-
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	1.7%	1.4%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	1.7%	1.5%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	474.9	497.6
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	416.9	461.3
Bilanci primar (në milionë euro)	58.0	36.3
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	5,765.2	6,226.2
prej të cilave: Bankat	3,811.4	4,033.3
Kredi	2,407.2	2,681.1
Depozita	3,046.9	3,210.1
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	6.5%	7.0%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	0.9%	1.4%
Hendeku i normës së interesit	5.6%	5.6%
Sektori i jashtëm*, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	295.6	250.7
prej të cilave: remitencat e pranuar	131.0	135.8
Llogaria financiare	142.1	122.2
Investimet e huaj direkte në Kosovë	64.8	42.0
Investimet portfolio, net	60.3	-91.5
Investimet tjera, net	17.6	27.1
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net	-182.5	-261.7
Asetet	4,664.3	4,754.4
Detyrimet	4,846.8	5,016.1
Borxhi i jashtëm, gjithsej	2,113.8	2,058.3
Borxhi i jashtëm privat	1,597.3	1,561.7
Borxhi i jashtëm publik	516.5	496.7

Burimi:

1/ ASK (2018).

2/ MF (2018).

3/ BQK (2018).

*Të dhënat për bilancin e pagesave përfshijnë muajt korrik dhe gusht ndërsa për PNI dhe borxh të jashtëm TM2

